

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
BASHKINË BELSH

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në Bashkinë Belsh, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik dhe financiar*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2013 deri më 31.12.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 34, datë 31.03.2016

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 1103/7 datë 05.04.2016, i ka rekomanduar z. Arif Tafani, Kryetar i Bashkisë Belsh, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi:

Për vitet 2013, 2014 dhe 2015, buxheti i bashkisë Belsh, është miratuar me vendime të Këshillit të Bashkisë brenda afateve ligjore.

Në përfundim të periudhave ushtrimore, për vitet 2013 dhe 2014, janë miratuar buxhetet faktike të shpenzimeve me vendime të Këshillit të Bashkisë, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore“, i ndryshuar. Në vitin 2013 buxheti është realizuar në masën 72%, në vitin 2014 është realizuar 69% dhe në vitin 2015 është realizuar 73%.

Të ardhurat nga tatim taksat lokale në vitin 2013 janë realizuar në masën 65%, në vitin 2014 realizuar 81% dhe në vitin 2015 realizuar 91%.

1.1. Rekomandimi:

Bashkia Belsh, të marrë masat e nevojshme për rishikimin e buxhetit të vit 2016, mbi bazën e programimit dhe arkëtimit të ardhurave nga tatim taksat lokale, duke marrë në konsideratë resurset që krijohen si rrjedhojë e reformës territoriale, ku në administrim të saj përfshihen, ish komunat: Grekan, Kajan, Fierzë dhe Rrasë.

Brenda muajit Maj 2016

2. Gjetje nga auditimi:

Nga Bashkia Belsh, janë nxjerrë pasqyrat financiare për aktivitetin e viteve 2013 dhe 2014.

Për vitin 2015, Bashkia Belsh, nuk ka përgatitur pasqyrat financiare të konsoliduara ku të jenë përfshirë llogaritë dhe treguesit financiarë të ish komunave; Rrasë, Grekan, Fierzë dhe Kajan, sot Njësi Administrative të kësaj bashkie.

Veprimet janë regjistruar sipas llogarive të planit kontabël miratuar me VKM Nr. 25, datë 20.01.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe të njësive që varen prej tyre” si dhe kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar.

U konstatua se llogaria e aktivitetit të bilancit 202 “Shpenzime për studime ose kërkime”, vlera totale e të cilës përfshin katër njësitë administrative të bashkisë Belsh, është 9,786,912 lekë. Kjo llogari, në analizë të saj, ka të evidentuar vlerën e shpenzimeve për studime, projektimi dhe oponenca teknike të kryera në vite.

Për këto aktive, nuk janë hapur kartela inventariale për personat që i kanë në ngarkim dhe i administrojnë këto studime dhe projekte.

Mungesa e kartelave inventariale, për sa janë regjistruar në debi të kësaj llogarie studime dhe projekte, është praktikë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, neni 7 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III pikat 26, 35/b, 35/c dhe kap IV, pika 73.

-Llogaria 215 “Mjete transporti”. Vlera kontabël e kësaj llogarie, sipas pasqyrave financiare të bashkisë Belsh dhe të 4 njësive administrative, ish komunat Grekan, Kajan, Fierzë dhe Rrasë, është në total për vlerën 19,260,379 lekë si vijon:

Bashkia Belsh	3,690,400 lekë,
Njësia Administrative Grekan	8,037,679 lekë,
Njësia Administrative Kajan	6,633,300 lekë,
Njësia Administrative Fierzë	899,000 lekë,
Njësia Administrative Rrasë	0 lekë.

Nga të dhënat e kartelave të inventarëve dhe procesverbaleve të komisionit për marrjen në dorëzim të mjeteve të transportit nga Njësitë Administrative, u konstatua se:

Për Njësinë Administrative Kajan, është deklaruar i vjedhur auto vetura tip Benz me vlerë kontabël 946,900 lekë, kurse automjeti tip fadrom dhe kamion tip benx me vlerën kontabël 3,492,000+ 2,194,800= 5,686,800 lekë, janë dhënë për ruajtje nga ish drejtuesit e komunës, në një subjekt privat sipas aktmarrëveshjes e datës 15.06.2015 të lidhur me këtë subjekt.

Për sa më sipër, pasqyrat financiare të Njesisë Administrative Kajan, nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen kontabël të llogarisë 215 “Mjete transporti”, për vlerën totale 6,633,700 lekë gjë e cila është shkelje e kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar.

Gjendja debitore në pasqyrat financiare të bashkisë Belsh, llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, nuk paraqet me vërtetësi vlerën totale të detyrimeve debitore për shumën 8,624,230 lekë, vlerë e cila përfaqëson rekomandimet nga auditimi i kaluar i KLSH-së, të pa kontabilizuara megjithëse ka dalë urdhër zhdëmtimi nga ish titullari i kësaj bashkie.

Kjo praktikë, është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar dhe VKM nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe të njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.1.2001.

2.1.Rekomandimi:

Bashkia e Belshit, të marrë masat:

-Të përgatisë pasqyrat financiare të konsoliduara me të dhënat e pasqyrave financiare të ish Komunave; Rrasë, Grekan, Fierzë dhe Kajan, sot njësi administrative të kësaj Bashkie.

-Të bëjë inventarizimin e llogarive inventariale për të verifikuar vërtetësinë e tregueseve të pasqyrave financiare që ka marrë në dorëzim nga ish komunat; Rrasë, Grekan, Fierzë, Kajan dhe për çdo rast mungesash, të ngarkojë me përgjegjësi personat përkatës.

-Të inventarizojë gjithë dokumentacioni teknik si projekte, preventiva dhe studime të kryera në vite në bashkinë Belsh dhe në njësitë administrative të saj.

3.Gjetje nga auditimi:

Për vitin 2015, bashkia Belsh, nuk e ka rishikuar programin e të ardhurave lokale meqenëse në administrim të kësaj bashkie, në kuadër të reformës administrative, kanë kaluar edhe të ardhurat nga ish komunat; Rrasë, Kajan, Fierzë dhe Grekan.

Gjatë periudhës së auditimit, nga Zyra e Tatim Taksave, nuk ishte marrë në administrim i gjithë dokumentacioni i nevojshëm administrativ dhe ligjor nga njësitë administrative, ish Komunat; Rrasë, Kajan, Fierzë dhe Grekan me qëllim, vjeljen e detyrimeve për tatim taksat vendore në gjithë territorin administrativ të bashkisë Belsh pas zgjedhjeve vendore të vitit 2015.

Për bashkinë Belsh, në programimin e taksës mbi tokën bujqësore, konstatohet rezerve në masën 32%.

Regjistrat për evidentimin dhe vjeljen e detyrimeve për taksën e tokës, taksën mbi ndërtesat dhe për taksat e tjera familjare, nuk pasqyrojnë saktë detyrimet për çdo subjekt dhe pagesat e kryera, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 i ndryshuar me udhëzimet përkatëse të tij.

Nga të dhënat që disponohen në Zyrën e Tatim Taksave, konstatohet se një numër jo i vogël i fermerëve nuk kanë paguar taksën e tokës. Ky numër ka ardhur në rritje nga viti 2013 e në vazhdim. Konkretisht:

Në bashkinë Belsh: në vitin 2013 nuk kanë paguar taksën e tokës 1608 familje, në vitin 2014, nuk kanë paguar 1754 familje dhe në vitin 2015, nuk kanë paguar 1919 familje.

Në njësinë administrative Kajan: në vitin 2013 nuk kanë paguar taksën e tokës 750 familje, në vitin 2014, nuk kanë paguar 807 familje dhe në vitin 2015, nuk kanë paguar 1113 familje.

Në njësinë administrative Grekan: në vitin 2013 nuk kanë paguar taksën e tokës 456 familje, në vitin 2014, nuk kanë paguar 546 familje dhe në vitin 2015, nuk kanë paguar 622 familje.

3.1.Rekomandimi:

Bashkia Belsh, të marrë masat e nevojshme, për përpilimin e regjistrave në mënyrë elektronike me të dhënat e nevojshme për evidentimin dhe vjeljen e detyrimeve për taksën e tokës, taksën mbi ndërtesat dhe për taksat e tjera familjare, ku të përfshijnë të dhënat për gjithë territorin nën juridiksionin e vet përfshi ish komunat Kajan, Grekan, Fierzë dhe Rrasë, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar dhe VKM Nr. 510, datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave dhe për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial".

3.2.Rekomandimi:

Bashkia Belsh, të marrë masat e nevojshme, për përgatitjen e programit për të ardhurat nga tatimet dhe taksat lokale, sa më real, pa rezerva dhe të organizojë punën për vjeljen e tyre me qëllim që të përmirësojë treguesit e realizimit e të ardhurave lokale.

Brenda muajit Maj 2016

4. Gjetje nga auditimi:

Në Bashkinë Belsh, për vitin 2013, 2014 dhe 2015, nuk ka qenë organizuar struktura e Inspektoratit Mbrojtjes dhe Kontrollit të Territorit Vendor (IMTK) si strukturë më vete por kjo detyrë i është caktuar një punonjësi tjetër, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9780 datë 16.7.2007 "Për Inspektimin e Ndërtimit" i ndryshuar, nenet 4, 18.

Bashkia Belsh, nuk disponon të dhëna mbi gjendjen e territorit dhe ndërtimeve pa leje duke argumentuar se këtë funksion ja ka kaluar Këshillit të Qarkut Elbasan sipas miratimit me vendimin e Këshillit të Bashkisë Nr. 29, datë 3.9.2010, i protokolluar me nr. 304, datë 30.9.2010 “Për kalim kompetencash Inspektoratit Ndërtimor dhe Urbanistik Qarkut Elbasan” por nuk ka lidhur akt marrëveshje me Qarkun Elbasan për mbulimin e këtij shërbimi, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar nenet 8, 10, 12.

4.1. Rekomandimi:

Bashkia Belsh, të rishikojë strukturën organizative me qëllim krijimin e strukturës të Inspektoratit të Mbrojtjes dhe Kontrollit të Territorit Vendor, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 139/205 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligjit nr. 9780 datë 16.7.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit” i ndryshuar.

Brenda muajit Mars 2016

5. Gjetje nga auditimi:

-Në bashkinë Belsh, nuk disponoheshin të dhëna lidhur me mbrojtjen dhe kontrollin e territorit në njësitë administrative, ish Komunat: Kajan, Fierzë, Grekan dhe Rrasë.

Gjatë kohës së auditimit, u mundësuan të merren të dhëna mbi ndërtimet pa leje në njësitë Administrative: Grekan, Kajan dhe Fierzë kurse për Rrasën, nuk na u paraqitën të dhëna:

Në njësinë administrative Kajan, janë konstatuar në vitin 2014 gjithsej 11 raste të ndërtimeve pa leje për objekte shtëpi banimi për të cilat janë mbajtur akte pezullimi.

Për këto konstatime, nuk janë vazhduar më tej procedurat për vendosjen e masës së gjobës, prishje të objektit pa leje ose kallëzime penale.

Vlera e gjobës të pa vendosur për këto raste, llogaritet **5,500,000 lekë e ardhur e munguar.**

Në njësinë administrative Grekan, janë konstatuar në vitin 2014 gjithsej 5 raste të ndërtimeve pa leje për objekte shtëpi banimi për të cilat janë mbajtur akte pezullimi.

Për këto konstatime, nuk janë vazhduar më tej procedurat për vendosjen e masës së gjobës, prishje të objektit pa leje ose kallëzime penale.

Vlera e gjobës të pa vendosur për këto raste, llogaritet **2,500,000 lekë e ardhur e munguar.**

Në njësinë administrative Fierzë, janë konstatuar në vitin 2014 gjithsej 73 raste të ndërtimeve pa leje për objekte shtëpi banimi për të cilat janë mbajtur akte pezullimi.

Për këto konstatime, nuk janë vazhduar më tej procedurat për vendosjen e masës së gjobës, prishje të objektit pa leje ose kallëzime penale.

Vlera e gjobës të pa vendosur për këto raste, llogaritet **36,500,000 lekë e ardhur e munguar.**

Mosveprimet janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 107 datë 31.7.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar neni 52/e dhe ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektoratin e ndërtimit” i ndryshuar, neni 13.

5.1. Rekomandimi:

Bashkia Belsh, të marrë masat e nevojshme për Organizimin e Kontrollit të Territorit duke rivlerësuar gjendjen e ndërtimeve pa leje në zbatim të kërkesave ligjore.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi:

Në bashkinë Belsh, për vitin 2015, procedurat e inventarizimit ishin në proces të pa përfunduara. Për vitin 2014, nuk është kryer inventarizimi i aktiveve, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. IV, pika 74.

Nga auditimi i procedurave të inventarizimit për vitin 2013, u konstatua:

Përbërja e komisioneve për nxjerrjen jashtë përdorimit të vlerave inventariale si dhe e komisionit të vlerësimit të inventarëve, janë me 3 persona kur duhej të ishin jo më pak se 5 persona, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011, Kap. IV, pika 100. Nga inventarizimi, kanë dalë jashtë përdorimit gjithsej 3,920.537 lekë vlera inventariale të cilat komisioni i vlerësimit, i ka asgjësuar ato pa bërë vlerësimin e tyre, kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011, Kap. IV, pikat 106, 107, 108, 109.

6.1. Rekomandimi:

Bashkia Belsh, të marrë masat për kryerjen e inventarizimit të aseteve, të formojë komisionet e inventarizimit me specialistët e nevojshëm, të bëjë vlerësimin e inventarëve që miratohen për tu nxjerr jashtë përdorimit në zbatim të kërkesave ligjore.

Vazhdimisht

7. Gjetje nga auditimi:

Për vitet 2013, 2014, dhe 2015, janë kryer shpenzime për blerje karburanti me procedurën e tenderimit në vlerën totale të kontratave për 4,877,485 lekë me tvsh për të cilën nuk ka certifikatë të cilësisë së karburantit dhe as analizë për çmimin e faturuar sipas kushteve të kontratës.

Për vitin 2013 kontrata është lidhur me subjektin “Hysa” për vlerën 1,488,425 lekë, për vitin 2014, kontrata është lidhur me subjektin “Diel Oil” shpk për vlerën 1,899,860 lekë dhe për vitin 2015, kontrata është lidhur me subjektin “Hysa” shpk për vlerën 1,489,200 lekë.

Kjo praktikë është shkelje e kërkesave të kontratës të lidhur midis palëve, ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 850 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2001 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, neni 42.

7.1. Rekomandimi:

Bashkia Belsh, të marrë masat, të nxjerrë përgjegjësitë për sa janë shkelur kërkesat ligjore në marrjen në dorëzim të karburantit të furnizuar dhe të zbatojë kushtet e kontratës sipas ofertës fituese.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi:

Për vitet 2013, 2014 dhe 2015, në Bashkinë Belsh, ka qenë organizuar dhe ka funksionuar policia bashkiake me dy punonjës. Të dy punonjësit e policisë, janë pa formimin përkatës në Akademinë e Policisë së Rendit dhe nuk i janë nënshtruar procedurës së zgjedhjes me komision, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 i ndryshuar, neni 4 dhe Urdhrit të Përbashkët të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 1530, datë 7.04.2003 dhe Ministrit të Rendit Publik, nr. 823, datë 11.04.2003 “Për miratimin e rregullores “TIP” të policisë bashkiake dhe të komunës”, Kreu III, neni 11, pika 5.

U konstatua se në aktivitetin e kësaj strukture, nuk janë dokumentuar raste të bashkëpunimit me Zyrën e Tatim Taksave për vjeljen e të ardhurave vendore dhe me Zyrën e Urbanistikës për konstatime ndërtime pa leje.

8.1. Rekomandimi:

Të riorganizohet struktura e policisë të bashkisë Belsh në përputhje me kërkesat ligjore, në mbështetje të strukturave të bashkisë për kontrollin e territorit, vjeljen e tatim taksave vendore, administrimin e aseteve.

Brenda muajit Qershor 2016

9. Gjetje nga auditimi:

Lidhur me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, është kryer verifikimi i zbatimit të detyrave dhe masave të rekomanduara. Me shkresën nr. 1016/45,

datë 30.06.2014, nga KLSH-ja është rikërkuar zbatimi i rekomandimeve për 3 masa organizative dhe për masat për shpërblim dëmi me vlerë 8,629,052 lekë.

Nga auditimi rezultoi se nga 3 masa organizative të ri kërkuara, 2 masa janë në proces zbatimi dhe 1 masë vlerësohet e pazbatuar.

Nga 14 masa shpërblim dëmi, 4 masa janë realizuar plotësisht, 4 masa janë në proces zbatimi dhe 6 masa nuk janë zbatuar.

Nga 59 persona të rekomanduar për shpërblim dëmi në shumën 8,629,052 lekë, kanë likuiduar plotësisht detyrimet 6 persona në shumën 206,754 lekë, është në proces zbatimi arkëtimi nga 37 persona të shumës 4,700,178 lekë dhe nuk janë zbatuar masat për arkëtimin nga 16 persona të shumës 3,722,120 lekë.

Nga këto, përfshihen detyrimet e 3 subjekteve juridike në shumën 3,650,682 lekë, ku për 2 prej tyre nuk janë ngritur padi gjyqësore dhe për 1 rast tjetër gjykata e ka mbyllur çështjen për arsye procedurale, për shkak të mos paraqitjes së palës paditëse, Bashkia Belsh.

9.1. Rekomandimi:

Të hartohet një program i ri pune për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja me shkresë nr. 1016/45, datë 30.06.2014, të zbatohen plotësisht 3 masat organizative të rekomanduara si dhe masat për shpërblim dëmi nga 53 persona në shumën 8,422,298 lekë duke ndjekur hap pas hapi proceset gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit.

Brenda muajit Qershor 2016

10. Gjetje nga auditimi:

Bashkia Belsh, nuk ka marrë masa trajnuese për njohjen dhe implementimin e kërkesave të ligjit nr. 10296 datë, 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

-Nuk janë përcaktuar Objektivat, Misioni dhe Vizioni i Bashkisë.

-Nuk janë dërguar në Ministrinë e Financës, Deklarata për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë, 08.07.2010, neni 18.

-Nuk ishte emëruar nëpunësi zbatues, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë, 08.07.2010, neni 9, pika 4/ç.

-Nuk është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS), në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë, 08.07.2010, neni 8, pika 8/b.

Për vitin 2013, Bashkia Belsh nuk ka hartuar Pyetësin e vetëvlerësimit “Për Funkcionimin e Sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”.

-Nuk është hartuar dhe miratuar Kod Etik për institucionin dhe strukturat në veçanti, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë, 08.07.2010, neni 20.

Rregullorja Brendshme e Bashkisë, e miratuar me vendim të Këshillit të Bashkisë nr. 9, datë 23.09.2012, nuk ka referenca për kodin etik.

-Nuk ishte krijuar regjistri i riskut, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010, neni 21.

10.1. Rekomandimi:

Bashkia Belsh, të marrë masa trajnuese nëpërmjet strukturave të saj dhe VORK-SHOP-eve të ndryshme në nivel bashkie ose qarku me qëllim njohjen dhe implementimin e kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” me qëllim zbatimin praktik të tij, prej strukturave të administratës së bashkisë për arritjen e objektivave, përdorimin sa më eficient, efektiv dhe ekonomik të burimeve financiare publike.

-Të përcaktojë si duhet Objektivat, Misionin dhe Vizionin e bashkisë dhe të informojë menaxherët dhe punonjësit e njësisë publike në lidhje me përmbajtjen e deklaratës së misionit, objektivave dhe të strategjisë.

-Të dërgojë çdo fillim viti, me shkresë zyrtare në Ministrinë e Financës, jo më vonë se fundi i muajit Shkurt i vitit aktual, “Deklaratën për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm” dhe Raportin “Për Funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm” për vitin e mëparshëm.

-Titullari i institucionit, të ngrejë Grupin për Menaxhimin Strategjik (GMS).

-Të marrë masa dhe të hartojë e miratojë Kodin Etik për Institucionin dhe strukturat në veçanti.

-Të përcaktojë dhe identifikojë risqet, të krijojë **regjistrin e riskut**, vlerësimin, kontrollin e risqeve që venë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ato drejtojnë

Brenda muajit Qershor 2016

11. Gjetje nga auditimi:

Bashkia Belsh, nuk ka marrë në dorëzim nga personat që i kanë pasur në inventar, automjetet në vlerën kontabël 6,633,700 lekë, pasuri e ish komunës Kajan, sot njësi administrative e bashkisë. Inventari dhe vlera e këtyre automjeteve, është si më poshtë:

Fadrom copë 1 për 3,492,000 lekë.

Kamion Benz copë 1 për 2,194,800 lekë

Veturë tip Benz copë 1 për 946.900 lekë

Sipas proces-verbalit të komisionit të inventarizimit datë 25.08.2015 ka konstatuar se këto automjete nuk gjendeshin në ambientet e kësaj njësie. Personat përgjegjës kanë deklaruar se mjeti tip Benz 2500 është vjedhur në vitin 2009 sipas vërtetimit fotokopje nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan me nr. 46/6 datë 7.10.2009 për regjistrimin e procedimit penal nr. 1066 datë 14.09.2009 **për vjedhjen e auto veturës tip benz.**

Automjetet tip Fadromë copë 1 me vlerë kontabël **3,492,000 lekë** dhe automjeti **kamion tip Benz** me vlerë kontabël **2,194,800 lekë**, nuk janë gjetur në njësinë administrative Kajan por sipas akt marrëveshjes të datë 15.06.2014 mbajtur midis ish kryetarit të komunës dhe administratorit të subjektit “P...A” shpk, këto mjete janë lënë në ruajtje në këtë subjekt.

Sipas procesverbalit të datës 7.12.2015 të komisionit të inventarizimit, këto mjete janë në subjektin “P...A” shpk por në gjendje të dëmtuar, jashtë përdorimit.

Për sa më sipër, administrimi i këtyre vlerave inventariale, është në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap I, nenet 5, 10, 12, 13 Kap. III, pika 36, ligjit nr. 9228, date 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar dhe ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil”, i ndryshuar neni 850.

11.1. Rekomandimi:

Bashkia Belsh, të vlerësojë procedurat ligjore për automjetin tip Benz të deklaruar të vjedhur, gjendjen fizike të mjetit tip fadrom me vlerë kontabël 3.492,000 lekë dhe kamionit tip Benz me vlerë kontabël 2,194,800 lekë. Të procedojë sipas kërkesave ligjore e të ngarkojë me përgjegjësi materiale për sa mjetet janë jashtë funksionimit nga mungesa e pjesëve të ndryshme si rezultat i vjedhjeve të mundshme.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi:

Në 8 raste për ***vlerën 2,459,240 lekë pa dëm ekonomik***, janë konstatuar shkelje në procedurat e blerjeve dhe shërbimeve me vlera të vogla, në të cilat mungon akti i marrjes në dorëzim të shërbimit të kryer ose në urdhrat e prokurimit, mungojnë specifikimet teknike të nevojshme për shërbimin që do të kryhet, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 23, VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu III, pika 1/ii, ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar neni 3, 5 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2001 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pikat 35/b, 42.

12.1. Rekomandimi:

Bashkia Belsh, të marrë mësa për riorganizohet komisioni i blerjeve dhe shërbimeve me vlera të vogla.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi:

Në bashkinë Belsh si dhe në 4 ish-komunat, sot njësi administrative; Grekanë, Fierzë, Kajan dhe Rrasë, në strukturën administrative të tyre, nuk ishin krijuar njësi të veçanta (zyra ose sektorë) me karakter të përkohshëm të cilat do të duhej të funksiononin deri në inventarizimin e plotë të aseteve dhe regjistrimin e tyre në ZVRPP Elbasan, në shkelje të kërkesave të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” të ndryshuar, pika 9.

13.1. Rekomandimi:

Bashkia Belsh, të miratojë në strukturën administrative të saj sektor të veçantë me funksion; identifikimin, marrjen në dorëzim, inventarizimin, vlerësimin dhe regjistrimin në ZVRPP të aseteve të qëndrueshme të miratuara në pronësi, me vendime të Këshillit të Ministrave.

Brenda muajit Qershor 2016

14. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi në bashkinë Belsh, u konstatua se për 1306 pronat e transferuara në këtë bashki sipas miratimit me VKM nr. 886, datë 3.11.2010, të cilat janë dhënë në pronësi dhe në përdorim, për periudhën objekt auditimi, nuk ishte ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të aseteve të qëndrueshme, si dhe nuk ishte kryer marrja në dorëzim, kolaudimi, vlerësimi, nuk ishte kryer inventarizimi kontabël dhe fizik, nuk ishte aplikuar në ZVRPP Elbasan për regjistrim, si dhe nuk ishte bërë regjistrimi në kontabilitet i aseteve, ***mosveprime këto në kundërshtim*** me kërkesat e ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” pikat 20, 21, 22, VKM Nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” pikat 37, 42-60, 74 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

14.1. Rekomandimi:

Bashkia Belsh, menjëherë pas krijimit të strukturës përkatëse, të marrë masa për funksionimin e saj, identifikimin, marrjen në dorëzim, kolaudimi, vlerësimin, regjistrimin në ZVRPP dhe kontabilizimin e aseteve të qëndrueshme, sipas miratimeve me vendime të Këshillit të Ministrave.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se në inventarin përfundimtar të pronave, të miratuar me VKM nr. 886, datë 3.11.2010, për shumë pasuri të Bashkisë Belsh, në kolonën “shënime të veçanta”

është vënë shënimi; “nuk gjendet në hartë”, “e ka në përdorim (emri i personit)”, “zënë forcërisht” ose “tjetërsuar”, “shitur” apo “privatizuar”, “e ka marrë pronari”, “nuk ekziston” etj.

Në **110 raste asete**, për sipërfaqen e përgjithshme të truallit prej **197,941 m²**, prej të cilave sipërfaqe ndërtimi 9,098 m², sipërfaqe funksionale 14,314 m², troje të lira 152,955 m², tokë arë 21,574 m², asetet janë në përdorim të tretëve, persona privatë të cilat i kanë zënë forcërisht.

Duke llogaritur qiranë për ndërtesat dhe trojet funksionale të zëna për periudhën 01.01.2013 deri më 20.02.2014 sipas VKM nr. 529, datë 08.06.2011, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, dhe për periudhën 21.02.2014 deri me 31.12.2015 sipas VKM nr. 54, datë 05.02.2014 të ndryshuar, *rezultojnë të ardhura të munguara në shumën 656,682,500 lekë.*

Për të gjitha rastet e mësipërme, nuk është vepruar nga ana e strukturave kompetente të bashkisë Belsh, për lirimin e pronave e asete të zëna forcërisht dhe për vënien e tyre në posedim të bashkisë.

15.1. Rekomandimi:

Bashkia Belsh, të marrë masa për verifikimin në teren të statusit juridik të aseteve të qëndrueshme sipas listës të miratuar me VKM nr. 886, datë 3.11.2010 dhe të veprohet sipas procedurave ligjore:

-në rastet kur asetet posedohen nga persona të tretë, të paautorizuar, të lajmërohen personat dhe të lidhen kontrata qiraje për trojet e lira, ndërtesat dhe trojet funksionale, duke kërkuar arkëtimin e të ardhurave të munguara në shumën 656,682,500 lekë.

-në rast se nuk arrihet marrëveshje me personat përkatës, të bëhet denoncim në organet kompetente të zbatimit të ligjit dhe të veprohet në bashkëpunim me strukturat e bashkisë, Policinë Bashkiake për lirimin e aseteve të zëna forcërisht dhe të vihen këto në posedim të bashkisë si pasuri në shërbim të komunitetit.

Brenda muajit Qershor 2016

16. Gjetje nga auditimi:

Nga ish Komuna Fierzë, është lidhur kontratë qira dhënie me kompaninë celulare AMC më datën 3.08.2014. Sipas kontratës janë dhënë me qira 300 m² truall me afat kohor 9 vjet.

U konstatua se tarifa e kontraktuar lekë/m²/muaj, është më e vogël se sa përcaktimet në VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, Kreu III, me një efekt vjetor më pak për 90,000 lekë të ardhura të munguara.

16.1. Rekomandimi:

Bashkia Belsh, të marrë masa dhe të rishikojë kontratën e qerasë së truallit me kompaninë celulare AMC të lidhur më datë 3.08.2014 dhe të fillojë negocimin me këtë kompani, me synim vendosjen e çmimit të qirasë për lekë/m² në muaj jo më pak se çmimi dysHEME i përcaktuar në kërkesat ligjore.

Brenda muajit Qershor 2016

17. Gjetje nga auditimi:

Në ish-komunën Grekan, janë transferuar 42 prona pyje dhe kullota komunale, të miratuara më VKM nr. 382, datë 27.03.2008 “Për Miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Grekan, të Qarkut të Elbasanit”, ku përfshihen sipërfaqe pyjore gjithsej 901 ha kryesisht me funksionin prodhues cungishte dhe të tjera brenda kësaj sipërfaqeje si: kullotë (15 ha) dhe inprodutive (4.5 ha) e sipërfaqe me bimësi pyjore 4 ha.

Nga ish-komuna Grekan, nuk ishte ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të aseteve, nuk ishte kryer inventari fizik dhe nuk ishte aplikuar në ZVRPP Elbasan për regjistrimin e tyre, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligjin nr. 10296, datë 8.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” pikat 20, 21 dhe 22, të VKM Nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” pikat 37, 42-60, 74, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

Nuk është proceduar për dhënien me qira të këtyre sipërfaqeve pyjore, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar, kreu IV, neni 19, ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për Fondin kullor” i ndryshuar, neni 18, VKM nr. 22, datë 9.01.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të administrimit të pyllit komunal” pika 6 dhe Udhëzimin e Ministrisë së Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave nr. 1, datë 2.7.2012 “Për përcaktimin e kriterëve të konkurrimit dhe procedurën e dhënies në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullor publik”, pika 7.

Për ruajtjen dhe administrimin e fondit pyjor, nuk është emëruar asnjë punonjës dhe nuk janë programuar fonde për investime në këtë sektor, sipas kërkesave të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 i ndryshuar, Kreu V, neni 23 dhe ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor” i ndryshuar, neni 14.

17.1. Rekomandimi:

Bashkia Belsh, të marrë masa për marrjen në dorëzim të aseteve, ku përfshihen 42 prona me sipërfaqe pyjore gjithsej 901 ha duke ngritur komisionet e kolaudimit, duke kryer vlerësimin, inventarizimin kontabël dhe fizik dhe të aplikohet në ZVRPP Elbasan për regjistrim e tyre.

Marrja në dorëzim e këtyre pronave dhe aseteve të qëndrueshme të bëhet me procesverbale të nënshkruara nga përfituesi Bashkia Belsh dhe nga institucionet qendrore si dorëzues.

Këto procesverbale duhet të jenë shoqëruar me hartat përkatëse në zbatim të procedurave ligjore.

Brenda muajit Qershor 2016

18. Gjetje nga auditimi:

Në ish-komunën Grekan, në inventarin paraprak të pronave, të miratuar me VKM nr. 912, datë 19.12.2007 për 7 **pasuri** në fushën e përdorimit: “Kulturë, sport”, “Mbrotjtje kombëtare”, për sipërfaqen e përgjithshme të truallit dhe ndërtimit prej **31,085 m²**, në kolonën “shënime të veçanta” është vënë shënimi, “e zënë forcërisht”.

Për të gjitha këto raste të zënies së pronave, nuk ka pasur asnjë denoncim në organet kompetente të zbatimit të ligjit dhe nuk është vepruar nga strukturat kompetente të ish komunës Grekan për lirim të tyre dhe vënien në shërbim të komunitetit.

18.1. Rekomandimi:

Bashkia Belsh, të marrë masa për identifikimin në terren të gjendjes juridike të aseteve të qëndrueshme sipas miratimit me VKM nr. 912, datë 19.12.2007 dhe inventarëve të ardhura nga ish komunat Rrasë, Kajan, Fierzë dhe Grekan si dhe të procedohet sipas kërkesave ligjore për administrimin e tyre.

Brenda muajit Qershor 2016

19. Gjetje nga auditimi:

Në procedurën me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratë e zhvilluara me objekt: “Rikonstruktion i shkollës 9-vjeçare “Halit Uruçi”, bashkia Belsh” **me fond limit**

59,912,575 lekë me TVSH, janë dhënë argumentime se bashkia ishte në kushtet e emergjencës, argument i cili nuk qëndron, për arsye se, autoriteti kontraktor nuk ka provuar, justifikuar apo dokumentuar se ka qenë në kushtet e emergjencës, kjo në kundërshtim me germën “c”, pika 2, neni 33 Procedura me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nuk përmbushet asnjë nga kushtet e përcaktuara në germën “a”, pika 5, kreu IV, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, pasi neglizhenca apo vonesat në fillimin e procedurave normale të prokurimit nuk janë shkaqe që argumentojnë zbatimin e kësaj procedure.

Si rrjedhojë kontrata është lidhur në kundërshtim me nenet 1 “Objekti dhe qëllimi”, 2 “Parimet e përzgjedhjes”, 4 “Fusha e zbatimit” dhe 29 “Procedurat standarde të prokurimit”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, për arsye se autoriteti kontraktor, në përcaktimin e fituesit, nuk ka zbatuar procedurat e parashikuara në këtë ligj, duke cenuar parimet e përzgjedhjes së fituesve të kontratave publike, mos diskriminimit dhe trajtimit të barabartë i ofertuesve dhe parimin e transparencës në procedurat e prokurimit, me pasojë favorizimin e një operatori ekonomik të caktuar të zgjedhur nëpërmjet procedurës me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës. *Efekt i garës (ulje të vlerës së vlerës së programuar të investimit) ka rezultuar në masën të papërfillshme prej 0.25% ose në vlerën -125,989 lekë.*

Veç kësaj autoriteti kontraktor kishte në dispozicion fondin më datë 10.06.2014 sipas vendimit të Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve nr. 6, datë 10.06.2014 “Për shpërndarjen e fondit për arsimin, fondit të zhvillimit të rajoneve, si dhe për një ndryshim në vendimin nr. 5, datë 09.05.2014, të Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve “Për shpalljen e thirrjes për ndarjen e fondit për arsimin, fondi për arsimin, fondi për zhvillimin e rajoneve, për Bashkinë Belsh është miratuar projekti i ndërtimit/ rikonstruksionit i shkollës 9-vjeçare “Halit Uruçi”, Belsh, me fond limit 59,912,575 lekë me TVSH.

Autoriteti kontraktor ka filluar zhvillimin e procedurës së prokurimit më datë 29.07.2014 **ose rreth 49 ditë më vonë**, duke u marrë me përgatitjen e shkresave dhe pritjen e përgjigjeve nga institucioneve të tjera si: Institucioni i Prefektit, Drejtoria Rajonale Arsimore Elbasan dhe Agjencia e Prokurimit Publik për justifikimin e përdorimit të procedurës me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, ndërkohë që afatet kohore për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje dhe për dorëzimin e ofertave në procedurën e hapur-punë janë 23 ditë kalendarike.

Referuar pikës 1, të nenit 12 “Përgjegjësia e autoritetit kontraktor”, të kreu II Organizimi i prokurimit publik”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, autoriteti kontraktor është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhjeje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij.

Në kuptimin e dispozitës së cituar më sipër autoriteti kontraktor duhet të kishte vlerësuar kushtet dhe rrethanat, në të cilin ndodhet dhe më pas të përzgjidhte procedurën përkatëse të prokurimit.

19.1.Rekomandim:

Bashkia Belsh, të përdorin vetëm për raste të veçanta procedurën “me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, sepse në këtë procedurë efekti i garës ka rezultuar në masën të papërfillshme në vlerën -125,989 lekë ose 99.75% e fondit limit.

Në vijimësi

20.Gjetje nga auditimi:

Në 14 procedura prokurimi **në vlerën 161,209,735 lekë pa TVSH**, nga të cilat 5 objekte me fond limit 70,913,412 lekë pa TVSH në bashkinë Belsh, 2 objekt me fond limit

1,559,245 lekë pa TVSH në ish komunë Rrasë, 2 objekt me fond limit 42,352,063 lekë pa TVSH, në ish komunën Grekan, 3 objekte me fond limit 1,849,951 lekë në ish komunën Kajan, dhe 2 objekte me fond limit 44,535,064 lekë në ish komunën Fierzë, shërbimi i hartimit të projektit të zbatimit, nuk është tenderuar, në kundërshtim me nenin 35 Konkurs projektimi, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 38 Konkursi i projektimit, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe DST, për arsye se autoriteti kontraktor, në përcaktimin e fituesit, nuk ka zbatuar asnjë nga procedurat e parashikuara në këtë ligj.

20.1.Rekomandim: Bashkia Belsh në të gjitha rastet e hartimit të projektit të zbatimit duhet të organizojë konkurs projektimi, duke iu nënshtruar procedurave të prokurimit publik për shërbim konsulentë ose konkurs projektimi konform dispozitave të fushës së prokurimeve publike.

20.2.Rekomandim:

Bashkia Belsh të marrë masat e nevojshme që Projekti Zbatimit, Raporti Teknik, Specifikimet dhe Preventivi detyrimisht duhet të hartohen nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse konformë nenit 5, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

Në vijimësi

21.Gjetje nga auditimi:

Në 9 objekte zbatimi në vlerën **111,470,985 lekë pa TVSH**, nga të cilat 4 objekte me fond limit 69,240,332 lekë pa TVSH në bashkinë Belsh, 1 objekt me fond limit 249,985 lekë pa TVSH në ish komunë Rrasë, 1 objekt me fond limit 40,130,717 lekë pa TVSH, në ish komunën Grekan dhe 3 objekte me fond limit 1,849,951 lekë në ish Komunën Kajan, nëpunësit autorizues (ish kryetarët e bashkisë/komunës) nuk kanë zhvilluar procedurë prokurimi për mbikëqyrje punimesh në kundërshtim me nenet 1, 2, 4 dhe 29 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2001, për arsye se autoriteti kontraktor, nuk ka zbatuar asnjë nga procedurat e parashikuara në këtë ligj.

21.1.Rekomandim:

Bashkia Belsh të marrë masa që shërbimi i mbikëqyrjes së punimeve të zbatimit detyrimisht të tenderohet, duke iu nënshtruar procedurave të prokurimit publik për kontrata-shërbimesh konform UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

Në vijimësi

22.Gjetje nga auditimi:

Nëpunësit autorizues të bashkisë Belsh dhe ish komunave Rrasë, Grekan, Kajan dhe Fierzë, nuk kanë urdhëruar përgatitjen e kërkesave dhe hartimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike për vitet 2013, 2014, 2015 në kundërshtim me shkronjën “b” Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik, pikës 3, kreu I, organizimi i prokurimit publik, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe me pikën 2, të neni 4 “Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik, kreu I, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

22.1..Rekomandim:

Bashkia Belsh, të marrë masat e nevojshme, për hartimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike të vitit vijues e të dërgohet në Agjencinë e Prokurimeve Publike në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2, datë 27.01.2015

“Për hartimin e Regjistrit të Parashikimeve të Prokurimit Publik dhe Regjistrit të Realizimeve të Prokurimit Publik”.

Në vijimësi

23.Gjetje nga auditimi:

Bashkia Belsh dhe ish komunat Rrasë, Grekan, Kajan dhe Fierzë, nuk kanë përgatitur një informacion të hollësishëm për veprimtaritë e realizuara të prokurimit për çdo katër muaj si dhe raport mbi realizimin e prokurimeve për vitet 2013, 2014 dhe 2015 (për ish komunat vetëm 4 muaji i parë), në kundërshtim me shkronjën “d”, Raportimi i realizimeve të prokurimit publik pikës 3, kreut I organizimi i prokurimit publik, të VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

23.1.Rekomandim:

Bashkia Belsh, të marrë masa për hartimin e raportit të realizimit të prokurimeve dhe regjistrit të realizimit të prokurimeve publike të vitit vijues e të dërgohen në Agjencinë e Prokurimeve Publike në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të APP Nr. 2, datë 27.01.2015 “Për hartimin e Regjistrit të Parashikimeve të Prokurimit Publik dhe Regjistrit të Realizimeve të Prokurimit Publik”.

Në vijimësi

24.Gjetje nga auditimi:

Në mbështetje të Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 57 datë 11.6.2014, pika 3 në të cilën përcaktohet që: “Në referim të gjurmës standarde të auditimit, Titullari i çdo njësie publike të qeverisjes së përgjithshme të hartojë gjurmën e detajuar të auditimit për njësitë që drejtojnë”, duhet të ishte hartuar e miratuar gjurma e detajuar e auditimit, e cila do të përbëjë një bazë të hapave dhe procedurave që duhet të ndjekin të gjitha strukturat e bashkisë Belsh dhe ish Komunat Rrasë, Grekan, Kajan dhe Fierzë, në këtë proces.

24.1.Rekomandim:

Bashkia Belsh të marrë masat e nevojshme për hartimin e gjurmëve të detajuara të auditimit për prokurimet publike dhe ta paraqesë për miratim tek kryetari i Bashkisë ose nëpunësi autorizues për procedurat e prokurimeve me vlerë të ulët dhe vlerë të lartë.

Menjëherë

25.Gjetje nga auditimi:

-Në dosjet e audituara nuk ka kërkesa nga zyrat përkatëse për objektin e prokurimit, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", ndryshuar, Kreu V.

-Autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar fondin limit të kontratave të mallrave, sipas metodologjisë së përcaktuar në dispozitë, kjo në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2010 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar , kreu III, pika 2, germa “c”.

-Nuk ka urdhër për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, Kreu II pika 2/c, ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 për "Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" , nenet 15 dhe 22.

-Në përcaktimet dhe miratimet e kriterëve të veçanta të kualifikimit, ka mangësi, për arsye se kriteret e përdorura për identifikimin e ofertës ekonomikisht më të favorshme nuk i plotësojnë kushtet e nenit 46, pika 1, e LPP-së, për arsye se, nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës; nuk janë objektive, përpjesëtimore me kontratën objekt prokurimi; nuk janë të përcaktuara qartë në njoftimin e kontratës apo në dokumentet e tenderave.

-Kriteret e përdorura për vlerësimin e ofertave nuk janë specifikuar në mënyrë të saktë nga ana e autoritetit kontraktor, për rrjedhojë lejojnë Komisionin e Vlerësimit të Ofertave, t'i interpretojnë ato në mënyra të ndryshme në procedura të ndryshme madje në disa raste me impakt financiar në dëm të autoritetit kontraktor.

-Dokumentet e kërkuara për të vërtetuar realizimin e kriterëve të kualifikimit, nuk kanë argumentim me hollësi të tyre, kjo në kundërshtim me pikën 3 të nenin 46 të LPP-së dhe germa "a" pika 3, Kreu III, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar, në të cilin përcaktohet se, për vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, të parashikuar në Ligjin e Prokurimeve Publike (LPP) dhe në këto rregulla, njësia duhet të argumentojë me hollësi vendosjen e tyre, sipas natyrës dhe vëllimit të kontratës, duke nxitur pjesëmarrjen e Operatorëve Ekonomik, veçanërisht biznesit të vogël. Kërkesa të cilat kanë çuar në rritjen e kostos së punëve, duke paguar më shumë për diferencat në kualifikimin e ofertuesve, pa arritur efektivitet ekonomik në realizimin e prokurimit.

Referuar tenderëve të zhvilluara për periudhën 2013-2015 rezulton se: Nga 15 procedura prokurimi të zhvilluara gjithsej 12 procedura prokurimi janë zhvilluar me 1 operator ekonomik dhe rreth 50% e tyre janë fituar nga operatori ekonomik "Blerimi", gjë që tregon se nëpërmjet kriterëve të veçanta të kualifikimit nuk është nxitur pjesëmarrja dhe konkurrenca ndërmjet operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik të zhvilluar nga bashkia Belsh dhe ish komunat Rrasë, Grekan, Kajan dhe Fierzë.

25.1.Rekomandim:

Bashkia Belsh duhet të forcojnë kontrollin e brendshëm në lidhje me procedurat e planifikimit dhe prokurimit. Konkretisht:

Në llogaritjen dhe argumentimin e fondit limit, në hartimin dhe vlerësimin e specifikimeve teknike, në hartimin e Projektit të Zbatimit, Raportit Teknik, Specifikimet dhe Preventivin, në përgatitjen, miratimin dhe hedhjen në sistem e dokumenteve të tenderit në mbikëqyrjen e zbatimit të kontratës, kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të punimeve, mallrave dhe shërbimeve, likuidimin e transaksioneve dhe zbatimin e detyrimeve kontraktuale.

Në vijimësi

26.Gjetje nga auditimi:

-Në disa raste (trajtuar me hollësisht në çdo procedurë të audituar) arkivimi i kontratës së lidhur është bërë me shumë vonesë nga botimi i kontratës së lidhur, duke mos zbatuar afatin e përcaktuar të arkivimit të procedurës brenda 1 dite pune nga mbyllja e fazës së njoftimit të kontratës së lidhur, e përcaktuar, kjo në Udhëzimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 3, datë 01.06.2010 "Për shpalljen e njoftimit të kontratës, njoftimit të fituesit dhe njoftimit të kontratës së lidhur në sistemin e prokurimit elektronik" i ndryshuar, me udhëzimin nr. 2, datë 03.04.2014.

-Në disa raste (trajtuar me hollësisht në çdo procedurë të audituar) arkivimi i kontratës rezulton me status të papërfunduar, ndërkohe që njoftimi i lidhjes së kontratës rezulton me status të përfunduar.

26.1.Rekomandim:

Bashkia Belsh të marrë masat e nevojshme për arkivimin e kontratave për procedurat e prokurimeve të përfunduara dhe në të ardhmen arkivimi i kontratave të lidhura të bëhet brenda 1 dite pune nga mbyllja e fazës së njoftimit të kontratës së lidhur, me qëllim që edhe faza e fundit e arkivimit të procedurave të prokurimeve elektronike - Arkivimi i kontratës rezultoi me status të përfunduar, dhe brenda afatit të përcaktuar në Udhëzimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 3, datë 01.06.2010 "Për shpalljen e njoftimit të kontratës, njoftimit

të fituesit dhe njoftimit të kontratës së lidhur në sistemin e prokurimit elektronik" i ndryshuar, me udhëzimin nr. 2, datë 03.04.2014.

Në vijimësi

27.Gjetje nga auditimi:

Dorëzimi i dokumentacionit të operatorit fitues nuk është bërë me anë të protokollit të bashkisë/komunës dhe në mungesë të tij nuk ka procesverbal të veçantë midis KVO-së dhe operatorit ekonomik siç parashikohet në neni 58 pika 4, 5, neni 63, të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, Kreu V pika 4, kreu III pika "ë", të VKM nr. 1, date 10.01.2007 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar dhe në Kreut II 'Prokurimi', pika 25, të urdhrit nr. 57, datë 12.6.201, të Ministrit të Financave.

27.1.Rekomandimi:

Bashkia Belsh të marrë masa e nevojshme për dokumentimin e marrjes në dorëzim të dokumentacionit ligjor dhe financiar nga operatori ekonomik fitues, duke mbajtur procesverbal për vlerësimin e dokumenteve fizike.

Në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Nga bashkia Belsh, të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim për shpërblimin e dëmit në **vlerën 40,846,244 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi:

Në objektin "*Sistemin i kanalizimeve të ujërave të zeza për fshatin Dëshiran, komuna Grekan*", nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **5,872,350 lekë pa t.v.sh. me dëm ekonomik**.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 dhe 12 të ligjit nr. 8402 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*", i ndryshuar, kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr.- prot. datë 09.08.2013 të lidhur midis ish Titullarit të Autoritetit Kontraktor, komuna Grekan dhe bashkimit të operatorëve ekonomik: "*G...G*" sh.p.k dhe "*B...I*" shpk, kontratën me nr. - prot., datë 09.08.2013 të lidhur midis ish Titullarit të Autoritetit Kontraktor, komuna Grekan dhe subjektit: "*Zenit - 06*" për mbikëqyrjen e punimeve, pikat 2, 3, kontrata me nr. - prot., datë 09.08.2013 e lidhur midis ish Autoritetit Kontraktor, komuna Grekan për kolaudimin e punimeve, nenet 2, 3, Udhëzimin nr. 1 datë 16.06.2011 "*Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*", pika b, nr. 3.3 paragrafi i dytë, Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*" i ndryshuar, Kreu II, pika 8.3, VKM Nr. 514, datë 15.8.2007 "*Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, pikat 2, 3 dhe 9.

1.1. Rekomandim:

Nga Bashkia Belsh, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **5,872,350 lekë pa t.v.sh** nga bashkimi i operatorëve ekonomik "*G...G*" sh.p.k dhe "*B...I*" sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësve të punimeve sipas kontratës datë 09.08.2013 me objekt: "*Sistemin i*

kanalizimeve të ujërave të zeza për fshatin Dëshiran, Komuna Grekan” , vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore për punime të pakryera.

Brenda muajit Maj 2016

2. Gjetje nga auditimi:

Në objektin: *“Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugëve të brendshme të bashkisë”* Belsh, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **2,292,825 lekë pa t.v.sh.** me dëm ekonomik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 dhe 12 të ligjit nr. 8402 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”*, i ndryshuar, kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 410 prot. datë 20.05.2015 të lidhur midis ish- Titullarit të Autoritetit Kontraktor dhe bashkimit të operatorëve ekonomik: *“B...I”* sh.p.k dhe *“B...N”* sh.p.k, kontratën me nr. 465/2 prot., datë 20.06.2015 të lidhur mes ish- Titullarit të Autoritetit Kontraktor dhe subjektit *“Z...T”* për mbikëqyrjen e punimeve, konkretisht pikat 2, 3, 11 dhe 12, kontrata me nr. 461/1 prot., datë 20.06.2015 e lidhur midis ish -Titullarit të Autoritetit Kontraktor për kolaudimin e punimeve, konkretisht neni 2, paragrafi i dytë dhe neni 7, VKM Nr. 514, datë 15.8.2007 *“Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”*, i ndryshuar, pikat 2, 3 dhe 9.

2.1. Rekomandim:

Nga bashkia Belsh, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **2,292,825 lekë pa t.v.sh** nga bashkimi i operatorëve ekonomik: *“B...I”* sh.p.k dhe *“B...N”* sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësve në kontratën nr. 410 prot. datë 20.05.2015 me objekt *“Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugëve të brendshme të bashkisë”* Belsh, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Brenda muajit Maj 2016

3. Gjetje nga auditimi:

Në objektin: *“Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugëve kryesore të qytetit”* Belsh, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **1,689,231 lekë pa t.v.sh.** me dëm ekonomik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 dhe 12 të ligjit nr. 8402 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”*, i ndryshuar, kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 5 prot. datë 12.11.2012 të lidhur mes ish-Titullarit të Autoritetit Kontraktor dhe bashkimit të operatorëve ekonomik: *“B...I”* sh.p.k, *“B...N”* sh.p.k dhe *“H...A”* sh.p.k, kontratën me nr. 5/2 prot., datë 12.11.2012 të lidhur midis ish-Titullarit të Autoritetit Kontraktor dhe ing. D.P. për mbikëqyrjen e punimeve, konkretisht pika 1.

3.1. Rekomandim:

Nga bashkia Belsh, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,689,231 lekë pa t.v.sh** nga bashkimi i operatorëve ekonomik *“B...I”* sh.p.k, *“B...N”* sh.p.k dhe *“H...A”* sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësve në kontratën nr. 5 prot., datë 12.11.2012 me objekt *“Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugëve kryesore të qytetit”*, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Brenda muajit Maj 2016

4. Gjetje nga auditimi:

Në objektin: *“Rikonstruksioni i Rrugëve të Bashkisë”* Belsh, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolauditimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **533,839 lekë pa t.v.sh.** me dëm ekonomik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 dhe 12 të ligjit nr. 8402 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”*, i ndryshuar, kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1567/12 prot. datë 10.12.2014 të lidhur mes ish-Titullarit të Autoritetit Kontraktor dhe bashkimit të operatorëve ekonomik *“A...A”* sh.p.k dhe *“V.H.”* sh.p.k, VKM nr.514, datë 15.8.2007 *“Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”*, i ndryshuar, pikat 2, 3 dhe 9.

4.1. Rekomandim:

Nga bashkia Belsh, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **533,839 lekë pa t.v.sh** nga bashkimi i operatorëve ekonomik *“A...A”* sh.p.k dhe *“V.H.”* sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësve në kontratën nr. 1567/12 prot., datë 10.12.2014 me objekt *“Rikonstruksioni i Rrugëve të Bashkisë”*, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Brenda muajit Maj 2016

5. Gjetje nga auditimi:

Bashkia Belsh, nuk ka marrë në dorëzim nga personat që i kanë pasur në inventar, automjetet në vlerën kontabël 8,028,679 lekë, pasuri e ish komunës Grekan, sot njësi administrative e bashkisë.

Inventari dhe vlera e këtyre automjeteve, është si më poshtë:

Fadrom copë 1 për 2,990,000 lekë.

Makinë transporti copë 1 për 4,048,679 lekë

Veturë tip Benx copë 1 për 990,000 lekë

Sipas procesverbaleve të datës 25.08.2015 dhe datës 11.12.2015, komisioni i inventarizimit ka konstatuar se këto automjete nuk gjendeshin në ambientet e kësaj Njësie për ti marrë nën administrim të bashkisë Belsh.

Personat përgjegjës kanë deklaruar se këto mjete i kanë dorëzuar në njësitë administrative por për këtë gjë nuk kanë nënshkruar dokument.

Për këto mungesa të aktiveve të qëndrueshme **në vlerën 8,028,679 lekë me dëm ekonomik** për bashkinë Belsh, nga titullari i saj, nuk janë marrë veprime të mëtejshme ligjore ndaj personave që i kanë pasur në inventar dhe që nuk i kanë dorëzuar, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”* Kap I, nenet 10, 12 Kap. IV, pikat 89, 90, 91, 93 dhe ligjit nr. 9228, date 29.4.2004 *“Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”* i ndryshuar, neni 7.

5.1. Rekomandimi:

Bashkia Belsh, të marrë masa administrative e ligjore dhe të kërkojë arkëtimin e vlerës së dëmit ndaj personave që i kanë pasur në inventar mjetet e transportit por nuk i kanë dorëzuar në vlerën totale **8,028,679 lekë** si dhe të bëjë kallëzim penal pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan për:

-N.C. për mjetin Fadromin në vlerën 2,990,000 lekë.

-K.K. për mjetin e transportit me vlerë kontabël 4,048,679 lekë.

-XH.Z. për mjetin veturë tip Benz me vlerë kontabël 999,000 lekë

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi:

Për evidentimin e konsumit të karburantit, bashkia Belsh ka miratuar normat e konsumit për automjetet në inventar.

Evidentimi i konsumit të karburantit për auto veturën tip Benz, është bërë sipas fletëve të udhëtimit në të cilat është shënuar data, destinacioni i lëvizjes së mjetit dhe km rrugë të përshkuara. Fletët e udhëtimit, përgjithësisht, janë të firmosura nga drejtuesi i mjetit, dhe të miratuara nga kryetari i bashkisë. Në asnjë rast, fletët e udhëtimit nuk janë të firmosura nga personi udhëtues.

Me këtë procedurë, është evidentuar konsumi i karburantit për vlerën totale **264,128 lekë shkelje e disiplinës financiare pa dëm ekonomik**.

U konstatua se fletët e udhëtimit për muajin Prill 2015, për auto veturën tip Benz, nuk janë të firmosura nga personi udhëtues dhe as janë miratuar nga titullari i bashkisë por vetëm nga drejtuesi i mjetit SH.H.

Në këto fletë udhëtimi, është evidentuar konsum karburanti për 943 litra të vlerësuar **për vlerën 162,196 lekë me dëm ekonomik**, veprime në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kap. I, pika 5, Kap. III, pika 35/b, 36.

6.1. Rekomandimi:

Nga Bashkia, të procedohet sipas kërkesave ligjore, për arkëtimin e vlerës 162,196 lekë nga ish drejtuesi i mjetit z. SH.H.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi:

Në bashkinë Belsh, gjatë vitit 2014 janë paguar 29 kryetarë të fshatrave dhe anëtarë të këshillit të bashkisë, për të cilët nuk është llogaritur dhe ndalur tatimi në burim mbi të ardhurat në masën 15 % për vlerën **115,275 lekë me dëm ekonomik**, shkelje e kërkesave të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

7.1. Rekomandimi:

Nga Bashkia, të procedohet sipas kërkesave ligjore, për arkëtimin e vlerës prej 115,275 lekë nga 29 ish kryetarë të fshatrave dhe anëtarë të këshillit të bashkisë.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi:

Gjatë vitit 2014, është paguar personi fizik M.M. shpenzime transporti për nxënësit e fshatit Stanaj-Belsh për periudhën 15.11.2014 deri më datën 15.6.2015. Pagesa është bërë me urdhër shpenzimin nr. 218, datë 18.12.2014, sipas faturës nr. 2 datë 17.12.2014, pa u kryer shërbimi, kjo në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pikat 35/b, 42, duke shkaktuar dëm ekonomik në **vlerën 396,000 lekë**.

8.1. Rekomandimi:

Nga Bashkia, të procedohet sipas kërkesave ligjore, për arkëtimin e vlerës prej 396,000 lekë nga personi fizik M.M.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi:

Me urdhër shpenzimin nr. 256, datë 14.12.2015, është paguar subjekti “V.H.” shpk për vlerën 1,353,996 lekë. Kjo pagesë i është referuar:

Kontratës të datës 30.06.2012 të lidhur midis ish komuna Grekan, sot njësia administrative e bashkisë Belsh dhe administratorit të subjektit “V.H.” shpk, me objekt: “Rikonstruksion dhe hapje të rrugëve të arave të komunës Grekan”.

Akti i marrjes në dorëzim të punimeve është datë 28.05.2015.

Situacioni përfundimtar i punimeve dhe fatura tatimore me nr. 40, është datë 30.05.2015, për vlerën totale 14,379,180 lekë me tvsh.

Sipas kontratës dhe dokumenteve të tenderit, afati i zbatimit të punimeve, është 30 ditë pas lidhjes së kontratës.

Subjekti “V.H.” shpk, nuk ka zbatuar kushtet e kontratës lidhur me afatet. Për këtë subjekt, nuk është llogaritur dhe nuk është kërkuar arkëtimi i penalitetit të llogaritur në masën 25 % të vlerës të $(13.660.221 * 25\%) = 3.415.055 \text{ lekë me efekt financiar}$, shkelje e kërkesave të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil”, i ndryshuar, nenet 850, 861 dhe UKM nr. 3, datë 15.2.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu I, pikat 4/d, 13 dhe 14.

9.1. Rekomandimi:

Bashkia Belsh, të kërkojë arkëtimin e penalitetit të llogaritur ndaj subjektit “V.H.” shpk në vlerën 3,415,055 lekë.

Brenda muajit Maj 2016

10. Gjetje nga auditimi:

Për ish-komunën Fierzë, nga informacioni i dhënë prej Zyrës së AMT në bashkinë Belsh dhe nga dosjet e vëna në dispozicion, rezulton se, gjatë vitit 2012, mbi bazën e ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën, të ndryshuar, të ligjit nr. 8312, datë 26.03.1995 “Për tokat bujqësore të pandara”, të VKM nr. 531, datë 21.08.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, UKM nr. 1, datë 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, nga ish-komuna Fierzë, Qarku Elbasan, janë lidhur kontrata qiraje gjithsej 57 kontrata qiraje me persona të ndryshëm për tokat bujqësore të pa ndara për sipërfaqen totale 59 ha.

Këto kontrata janë lidhur gjatë vitit 2012, bazuar urdhrin e Ministrit të Bujqësisë, UMK nr. 234, datë 09.07.2007 “Për miratimin e përmbajtjes dhe formës së “Kontratës tip për dhënie me qira të tokave bujqësore, të pandara, pasuri shtetërore” dhe të “Formularit tip të kërkesës për qiramarrje të tokës bujqësore”. Afati i këtyre kontratave, është 99 vjet.

Këto kontrata, nuk janë lidhur në prani të noterit, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Nga auditimi i kryer mbi 57 kontratat e lidhura dhe duke konsideruar pasqyrën e vënë në dispozicion nga ZMMT, në rrugë shkresore dhe elektronike, u konstatua se për vitet 2013, 2014, 2015, nga 40 qiramarrës nuk janë likuiduar detyrimet financiare për të 3 vitet, 13 qiramarrës kanë likuiduar detyrimet vetëm për vitin 2013, 2 qiramarrës kanë likuiduar detyrimet për vitet 2013 dhe 2014 dhe 2 qiramarrës kanë likuiduar plotësisht detyrimet për të tre vitet: 2013, 2014, 2015.

Në kontratat tip të lidhura, shprehet detyrimi i qiramarrësit: “*Pagesa e qirasë kryhet në fund të çdo tremujori, në masën 25 % të shumës së qerasë vjetore*”, si dhe në rubrikën “Sanksione” shprehet se: “*Qiramarrësi paguan gjobë 1 % të detyrimit për çdo ditë vonesë në pagesën e qirasë së përcaktuar në kushtet e kësaj kontrate*”.

Si rezultat i mos likuidimit në kohë të detyrimeve kontraktore të 57 subjekteve qiramarrës, deri në 3 mujin e III-të të vitit 2015, konstatohet një detyrim i përgjithshëm prej **5,242,519 lekë, nga të cilat 912,200 principal dhe 4,320,319 lekë gjoba (sanksione), shumë që përbën dëm ekonomik** për buxhetin e bashkisë Belsh (ish-Komuna Fierzë).

10.1. Rekomandimi:

Bashkia Belsh, të kontabllizojë shumën e detyrimit **5,242,519 lekë**, në ngarkim të 57 personave fizikë qiramarrës të tokave bujqësore të pandara, për detyrimet e pa likuiduara dhe gjobat (sanksionet) e pa vjela për të 3 vitet 2013, 2014 dhe 2015, shumë e cila është detyrim kontraktor i personave në fjalë dhe të kërkojë sipas ligjit, arkëtimin e dëmit ekonomik, duke ndjekur të gjithë rrugët administrative dhe gjyqësore, deri në shterimin e plotë të gjithë mundësive. Për personat që nuk paguajnë detyrimet, të bëhet anulimi i kontratës.

Brenda muajit Maj 2016

11. Gjetje nga auditimi:

Për ish-komunën Rrasë, nga informacioni i dhënë prej Zyrës së AMT në bashkinë Belsh (ish-komuna Rrasë) dhe nga dosjet e vëna në dispozicion, rezulton se, gjatë vitit 2012, mbi bazën e ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën, të ndryshuar, të ligjit nr. 8312, datë 26.03.1995 “Për tokat bujqësore të pandara”, të VKM nr. 531, datë 21.08.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, udhëzimit të KM nr. 1, datë 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, nga ish-komuna Rrasë, Qarku Elbasan, janë lidhur kontrata qiraje gjithsej 66 kontrata qiraje me persona të ndryshëm për tokat bujqësore të refuzuara, për një sipërfaqe të përgjithshme prej 49 ha.

Këto kontrata janë lidhur gjatë vitit 2012, bazuar urdhrin e Ministrit të Bujqësisë, UMK nr. 234, datë 09.07.2007 “Për miratimin e përmbajtjes dhe formës së “Kontratës tip për dhënie me qira të tokave bujqësore, të pandara, pasuri shtetërore” dhe të “Formularit tip të kërkesës për qiramarrje të tokës bujqësore”.

Nga auditimi i kryer mbi 66 kontratat e lidhura dhe duke konsideruar pasqyrën e vënë në dispozicion nga ZMMT, në rrugë shkresore, u konstatua se për vitet 2013, 2014, 2015, janë 23 qiramarrës të cilët nuk janë likuiduar detyrimet financiare për të 3 vitet, dhe për vitet 2014-2015 janë 43 qiramarrës të cilët nuk kanë likuiduar detyrimet për këto 2 vite.

Në kontratat tip të lidhura, shprehet detyrimi i qiramarrësit: “*Pagesa e qirasë kryhet në fund të çdo tremujori, në masën 25 % të shumës së qerasë vjetore*”, si dhe në rubrikën “Sanksione” shprehet se: “*Qiramarrësi paguan gjobë 1 % të detyrimit për çdo ditë vonesë në pagesën e qirasë së përcaktuar në kushtet e kësaj kontrate*”.

Si rezultat i mos likuidimit në kohë të detyrimeve kontraktore të 66 subjekteve qiramarrës, deri në 3 mujin e III-të të vitit 2015, konstatohet një detyrim i përgjithshëm prej **3,569,668 lekë**, nga të cilat **684.760 lekë** principal dhe **2,884,908 lekë** gjoba (sanksione), **shumë që përbën dëm ekonomik** për buxhetin e bashkisë Belsh (ish-Komuna Rrasë).

11.1. Rekomandimi:

Bashkia Belsh, të kontabllizojë shumën e detyrimit **3,569,668 lekë**, në ngarkim të 66 personave fizikë qiramarrës të tokave bujqësore të pandara, për detyrimet e pa likuiduara dhe gjobat (sanksionet) e pa vjela për të 3 vitet 2013, 2014 dhe 2015, shumë e cila është detyrim kontraktor i personave në fjalë dhe të kërkojë sipas ligjit, arkëtimin e dëmit ekonomik, duke ndjekur të gjithë rrugët administrative dhe gjyqësore, deri në shterimin e plotë të gjithë mundësive.

Brenda muajit Maj 2016

12. Gjetje nga auditimi:

Titullari i autoritetit kontraktor ish komuna Grekan më datë 30.09.2013, ka amenduar kontratën me objekt “Sistemim kanalizimeve të ujërave të zeza për fshatin Dëshiran, komuna Grekan”, duke ndryshuar afatin e zbatimit të punimeve me 206 ditë ose deri më datë 15.06.2014.

Amendimi i kontratës së sipërmarrjes është bërë në kundërshtim me nenin 33 Vonesa në zbatim dhe zgjatja e afatit, për arsye se, nuk kanë ekzistuar kushtet (Forca Madhore) për zgjatjen e afatit, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën **8,266,928 lekë**.

Zgjatja e afatit të zbatimit të punimeve me mbi 200 ditë është në kundërshtim me Formularin e Njoftimit të Kontratës, Grafikun e Punimeve (DST) dhe ofertën e operatorit ekonomik në të cilin përcaktohet se “afati për mbarimin e punimeve është 100 ditë pas lidhjes së kontratës” për arsye se, titullari i autoritetit kontraktor ka ndryshuar kriteret të cilat kanë përcaktuar ofertuesin fitues.

12.1.Rekomandim: Të merren masat dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **8,266,928 lekë**, nga operatori ekonomik “G...G” sh.p.k e cila përfaqëson shumën e moszbatimit të penaliteteve, në tenderin me objekt “Sistemim kanalizimeve te ujërave të zeza për fshatin Dëshiran, komuna Grekan” .

Brenda muajit Maj 2016

13. Gjetje nga auditimi: Shtyrja e afatit të zbatimit të kontratës me objekt “Ndriçime i rreth rrotullimit dhe rrugëve komunale, fshati Dëshiran, komuna Grekan”, është bërë në kundërshtim me Formularin e Njoftimit të Kontratës, Grafikun e Punimeve (DST) , ofertën e operatorit ekonomik dhe nenin 33 Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit, për arsye se, nuk kanë ekzistuar kushtet (Forca Madhore) për zgjatjen e afatit veç kësaj titullari i autoritetit kontraktor ka ndryshuar kriteret të cilat kanë përcaktuar ofertuesin fitues, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën **310,988 lekë**.

13.1.Rekomandim: Të merren masat dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **310,988 lekë**, nga operatori ekonomik “B...I” shpk e cila përfaqëson shumën e moszbatimit të penaliteteve, në tenderin me objekt “Sistemim kanalizimeve te ujërave të zeza për fshatin Dëshiran, komuna Grekan”.

Brenda muajit Maj 2016

14. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Rikonstruksion i rrugëve komunale, komuna Rrasë, viti 2015”, me fond limit 249 985 leke pa TVSH, rezultoi se KPVV-ja e përbërë nga z. R.Q., z. L.SH. dhe z. R.D. kanë s`kualifikuar operatorët ekonomik “A...A”, “A...A”, “D...A” dhe “U...L”, në kundërshtim me LPP, RrPP dhe Udhëzimit të APP, për arsye se, në këtë fazë asnjë operator ekonomik përfshi edhe ofertuesin e shpallur fitues nuk kanë paraqitur në sistem dokumentet e pranimit kualifikimit, *duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 39,000 lekë*.

14.1. Rekomandim: Autoritetit Kontraktor bashkia Belsh të kërkojë në rrugë ligjore shpërblimin e dëmit ekonomik në **vlerën 39000 lekë**, nga 3 anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, në mënyrë solidarë secili nga **13,000 lekë**, respektivisht: nga z. Rudin Qypi, z. Lulzim Shtylla dhe z. Ramazan Daullja, për arsye se, në cilësinë e anëtarëve të KPVV, kanë s`kualifikuar operatorët ekonomik “A...A”, “A...A”, “D...A” dhe “U...L”.

Brenda muajit Maj 2016

15. Gjetje nga auditimi:

Në procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje Shërbimi për supervizim, mbikëqyrje punimesh për objektin “Rikonstruksion dhe ndriçim i rrugëve komunale, komuna Fierze” me fond limit 400,000 leke pa TVSH, zhvilluar më datë 17.06.2013, rezultoi se, KPVV-ja ka përdorur dy standarde të ndryshme në shqyrtimin e ofertave të

operatorëve ekonomik duke s`kualifikuar ofertën e OE “Zenit 06” me vlerë më të ulët se OE i shpallur fitues, kjo në kundërshtim me Udhëzimin e APP, RrPP dhe LPP, për rrjedhojë kanë shkaktuar dëm ekonomik **në vlerën 220,000 lekë.**

15.1.Rekomandim:

Autoritetit Kontraktor bashkia Belsh të kërkojë në rrugë ligjore shpërblimin e dëmit ekonomik **në vlerën 220,000 lekë**, nga 3 anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, në mënyrë solidarë secili nga **72,000 lekë**, respektivisht: z. Sh.I. B.I. dhe L.S. për arsye se, në cilësinë e anëtarëve të KPVV, kanë s`kualifikuar operatorin ekonomik “Z...T”shpk me vlerë më të ulët se OE i shpallur fitues, kjo në kundërshtim me LPP, RRPP dhe Udhëzimit të APP-së.

Brenda muajit Maj 2016

16.Gjetje nga auditimi:

Në procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me “Rikonstrukcion i rrugëve komunale, komuna Fierzë” me fond limit 416,667 leke pa TVSH, 500,000 leke me TVSH, rezultoi se, KPVV-ja ka s`kualifikuar operatorët ekonomik INA, AGFA, ASI-2A CO,Tonin Ymeri, Alvora Delia Impex dhe Universal, në kundërshtim me LPP, RrPP dhe Udhëzimit të APP, për arsye se, në këtë fazë asnjë operator ekonomik përfshi edhe ofertuesin fitues nuk kanë paraqitur në sistem kriteret e pranimit kualifikimit, duke shkaktuar dëm ekonomik **në vlerën 216,001 lekë.**

16.1.Rekomandim:

Autoritetit Kontraktor bashkia Belsh të kërkojë në rrugë ligjore shpërblimin e dëmit ekonomik **në vlerën 216,000 lekë**, nga 3 anëtarët e Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël, në mënyrë solidarë secili nga **72,000 lekë**, respektivisht: z. B.P, z.R.H. dhe z. H.M, për arsye se, në cilësinë e anëtarëve të KPVV, kanë s`kualifikuar operatorët ekonomik “I...A”, “A...A”, “A...O”, T.Y, A.D. dhe “U...I”.

Brenda muajit Maj 2016

17. Pajisja me leje zhvillimore ndërtimi nr. 95, datë 16.07.2014, në ish komunën Kajan nuk është shoqëruar me pagesa të taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe tarifës për studim projektim **në vlerën 52,522 lekë**, e llogaritur në bazë të sipërfaqes së ndërtimit, çmimin për m2 të përcaktuar nga EKB-ja, taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe tarifën për studim projekte. Vlerë e cila përbën dëm ekonomik të arkëtueshëm nga z. G.E, në cilësinë e investitorit në objektin “Linjë për grumbullimin dhe përpunimin e ullirit”.

17.1.Rekomandim:

Bashkia Belsh, të kërkojë arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe tarifës për studim projektim **në vlerën 52,522 lekë**, nga z. G.E, në cilësinë e investitorit në objektin “Linjë për grumbullimin dhe përpunimin e ullirit”.

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi në bashkinë Belsh, rezultoi se janë dhënë me qira objekte për 7 persona fizikë, bazuar në kontrata 1 vjeçare, pra gjithsej duhej të paraqiteshin 21 kontrata qiraje për të 3 vitet (2013, 2014, 2015) dhe të kryhej pagesa çdo vit, sipas VKM 529, datë 08.06.2011 dhe VKM 54, datë 05.02.2014. Sipas listës, kontratat duhej të lidheshin çdo fillim viti, pra të rinovoheshin.

Nga ana e financës na u paraqitën vetëm 6 kontrata, pra 15 kontrata të tjera nuk janë lidhur, megjithëse objektet posedohen nga personat fizikë. Detyrimi i pa paguar për 6 persona për 3 vitet llogaritet në vlerën **369,168 lekë**, e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e

bashkisë Belsh. Nga verifikimi që u krye në Zyrën e Taksave Vendore, rezulton se personat e më sipërm, janë duke kryer aktivitet biznesi në këto agjente.

18.1. Rekomandimi:

Bashkia Belsh, të kontabilizojë shumën e detyrimit **369,168 lekë**, në ngarkim të 6 personave fizikë të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në asetet pronë e bashkisë dhe të kërkojë sipas ligjit, arkëtimin e dëmit ekonomik nga personat fizikë posedues të pronës bashkiake. Në vazhdim të lidhen me këta persona kontrata vjetore për dhënie me qira të ambienteve publike, ose në të kundërt (në rast refuzimi) të lajmërohen strukturat përkatëse dhe së bashku me Policinë Bashkiake, të ekzekutojnë forcërisht lirin e objekteve.

Menjëherë

C.MASA DISIPLINORE

Mbështetur në germa “e” dhe “ç”, neni 11, kreun IV, dhe nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe kontratës individuale tip, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë, fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore nga “**Vërejtje**”, për këta persona:

1. Z. SH.Z, me detyrë ish Përgjegjës i Zyrës së Financës për periudhën 1 Janar 2013 deri më 31 Gusht 2015, me detyrë Këshilltar Ekonomik nga data 1 Tetor 2015 e në vazhdim, në cilësinë e kryetarit të komisionit të blerjeve dhe shërbimeve me vlera të vogla bashkia Belsh.

-Gjatë viteve 2013-2015, janë paguar 17 anëtarë të këshillit të bashkisë pa marrë pjesë në mbledhje për shumën totale 1,772,850 lekë, shkelje e kërkesave të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “*Për organizimi dhe funksionimin e qeverisjes vendore*” të ndryshuar, neni 29.

-Në vitin 2014, nuk janë llogaritur e ndalur tatimi mbi të ardhurat për 29 këshilltarë në shumën 115,272 lekë me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit, shkelje e kërkesave të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar.

-Në vitin 2014, në 5 raste për vlerën 1,549,668 lekë në blerjet dhe shërbimet me vlera të vogla, nuk janë zbatuar korrekt procedurat e marrjes në dorëzim të shërbimit, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pikat 35/b, 42.

-Janë paguar faturat e blerjes së karburantit për shumën 1,899,860 lekë, pa kërkuar nga furnitorët analizën e çmimit të karburantit dhe certifikatën e cilësisë, në kundërshtim me kërkesat e kushteve të kontratës dhe ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar neni 850.

-Në pasqyrat financiare të vitit 2014 e në vazhdim, nuk janë pasqyruar debitorët e rekomanduara nga auditimi i KLSH-së dhe të pranuar nga subjekti, për vlerën 8,624,23 lekë, shkelje e kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar.

-Nuk është kryer inventarizimi i aktiveve të bashkisë për vitin 2014, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 74.

2. Z. A.N, me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Financës për periudhën 1 Shtator 2015 e në vazhdim.

-Nuk janë nxjerr debitorë dhe nuk është kërkuar në rrugë gjyqësore arkëtimi i dëmit për vlerën 8,028,679 lekë për sa janë konstatuar mangët mjetet të transportit në ish komunën Grekan sipas procesverbaleve të komisionit të inventarizimit datë 25.08.2015 dhe datë 11.12.2015, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-Nuk është llogaritur e ndalur penalteti në shumën 3,415,055 lekë, ndaj subjektit “V.H.” shpk për punime të pa kryera në afat sipas kontratës të lidhur datë 30.06.2012 me ish komunën Grekan.

Situacioni përfundimtar paguar në Bashkinë Belsh me urdhër shpenzimin nr. 256, datë 14.12.2015, është në kundërshtim me kërkesat e kontratës, ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar dhe UKM nr. Datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.

D. MASA ADMINISTRATIVE:

Nga auditimi i ushtruar në bashkinë Belsh dhe njësitë administrative (*ish Komunitat Rrasë, Grekan, Kajan dhe Fierzë*) u konstatuan mangësi dhe shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

Bazuar në germën “ç” të nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i rekomandojmë Agjencisë së Prokurimit Publik, që në zbatim të pikës 2, të nenit 72 “Kundërvajtjet administrative”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 79 Sanksionet administrative, Kreu XI “Sanksionet administrative dhe masat disiplinore”, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të shqyrtojë dhe të marrë masën administrative (Gjobë) ndaj anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, Specialistëve të Njesisë së Prokurimit dhe Titullarit të Autoritetit Kontraktor sipas përgjegjësisë përkatëse në Raportin Përfundimtar të Auditimit. Konkretisht:

D.1 Bashkia Belsh

1. z. A.K., ish Kryetar i Bashkisë, në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor .

2. z. A.G., në cilësinë e juristit në njësinë e prokurimit

3. z. SH.Z., në cilësinë e specialistit në njësinë e prokurimit

4. z. B.P., në cilësinë e specialistit në njësinë e prokurimit

Shërbimi i hartimit të projektit të zbatimit, në 5 procedura prokurimi **me fond limit 70,913,412 lekë pa TVSH** nuk është tenderuar, në kundërshtim me nenin 35 Konkurs projektimi, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 38 Konkursi i projektimit, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe DST, për arsye se, autoriteti kontraktor në përcaktimin e fituesit nuk ka zbatuar asnjë nga procedurat e parashikuara në këtë ligj.

-Autoriteti kontraktor nuk ka zhvilluar procedurë prokurimi për mbikëqyrje punimesh për objektin “Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “Halit Uruçi”, Bashkia Belsh, me fond limit 49,927,146 leke pa tvsh dhe 59,912,575 leke me tvsh, në kundërshtim me nenet 1, 2, 4 dhe 29 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” dhe Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të

ndërtimit”, i ndryshuar, për arsye se autoriteti kontraktor, nuk ka zbatuar asnjë nga procedurat e parashikuara në këtë ligj.

5. z. B.T, në cilësinë e kryetarit të komisionit të vlerësimit të ofertave.

6. zj. N.Z, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave.

7. z. R.B, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave.

8. z. B.P, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave.

Komisioni i vlerësimit të ofertave kanë kualifikuar operatorët ekonomik, në kundërshtim me nenin 46 “Kualifikimi ofertuesve dhe 53 “Shqyrtimi i ofertave”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kreut V zhvillimi i procedurave, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi kandidatët nuk plotësonin kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në DST.

9. z. L.S, në cilësinë e juristit në njësinë e prokurimit.

10. z.R.B, në cilësinë e specialistit në njësinë e prokurimit.

11. z. L.XH, në cilësinë e specialistit në njësinë e prokurimit.

12. zj. I.S.N, në cilësinë e juristit në njësinë e prokurimit.

-Në përcaktimet dhe miratimet e kriterëve të veçanta të kualifikimit, ka shkelje të dispozitave, pasi kriteret e përdorura për identifikimin e ofertës ekonomikisht më të favorshme nuk i plotësojnë kushtet e nenit 46 kualifikimi i ofertuesëve, pika 1, e LPP-së, pasi nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës; nuk janë objektive, përpjesëtimore me kontratën objekt prokurimi; nuk janë të përcaktuara qartë në njoftimin e kontratës apo në dokumentet e tenderëve.

-Kriteret e përdorura për vlerësimin e ofertave nuk janë specifikuar në mënyrë të saktë nga ana e autoritetit kontraktor, për rrjedhojë lejojnë Komisionin e Vlerësimit të Ofertave, t’i interpretojnë ato në mënyra të ndryshme në proceduar të ndryshme madje në disa raste me impakt financiar në dëm të autoritetit kontraktor **në vlerën 406,520 lekë.**

-NJP nuk ka dhënë argumentime mbi vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me RrPP, në të cilin përcaktohet se, për vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, të parashikuar në Ligjin e Prokurimeve Publike (LPP) dhe në këto rregulla, njësia duhet të argumentojë me hollësi vendosjen e tyre, sipas natyrës dhe vëllimit të kontratës, duke nxitur pjesëmarrjen e Operatorëve Ekonomik, veçanërisht biznesit të vogël. Kërkesa të tilla kanë çuar në rritjen e kostos së punëve, duke paguar më shumë për diferencat në kualifikimin e ofertuesëve, pa arritur efektivitet ekonomik në realizimin e prokurimit.

D.2. ish Komuna Rrasë

1. z. R.H, ish Kryetar i Komunës Rrasë, në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor.

- Projekti i zbatimit me objekt “Rikonstruksioni i rrugëve komunale, komuna Rrase”, me vlerë preventivi të objektit 1,309,260 lekë pa TVSH, nuk është tenderuar, në kundërshtim nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

- Autoritetit kontraktor nuk ka zhvilluar procedurë prokurimi për mbikëqyrje punimesh për objektin “Rikonstruksion i rrugëve komunale, komuna Rrase, viti 2015”, me fond limit 249,985 lekë pa TVSH , në kundërshtim me nenet 1, 2, 4 dhe 29 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

-Autoriteti kontraktor nuk ka hartuar projekt zbatimi për objektin “Rikonstruksion i rrugëve komunale, komuna rrase, viti 2015”, me fond limit 249,985 lekë, në kundërshtim me ligjin nr. 8402, date 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndërtimit”, i ndryshuar.

-Preventivi i punimeve i miratuara nga titullari i autoritetit kontraktor për objektin “Rikonstruksion i rrugëve komunale, komuna rrase, viti 2015”, me fond limit 249,985 lekë, është në kundërshtim me nenin 5, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, për arsye se, nuk është hartuar nga specialistë të pajisur me licencë profesionale në fushën e projektimit.

2. z. R.Q, në cilësinë e kryetarit të komisionit të vlerësimit të ofertave

3. z. D.H, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave

4. z. A.H, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave kanë kualifikuar operatorët ekonomik, në kundërshtim me nenin 46 “Kualifikimi ofertuesve dhe 53 “Shqyrtimi i ofertave”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kreut V zhvillimi i procedurave, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi kandidatët nuk plotësonin kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në DST.

5. z. L.S, në cilësinë e juristit në njësinë e prokurimit.

6. z. B.P, në cilësinë e specialistit në njësinë e prokurimit.

7. z. B.E, në cilësinë e specialistit në njësinë e prokurimit.

Njësia e Prokurimit nuk ka argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, konform me Rregullat e Prokurimit Publik, të miratuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 10.01.2007, kreu V, i ndryshuar, i cili përcakton se, për vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, të parashikuar në Ligjin e Prokurimeve Publike (LPP) dhe në këto rregulla, njësia duhet të argumentojë me hollësi vendosjen e tyre, sipas natyrës dhe vëllimit të kontratës. Kërkesat/kriteret e veçanta të kualifikimit kanë çuar në rritjen e kostos së punëve, shërbimeve dhe mallrave, duke paguar më shumë për diferencat në kualifikimin e ofertuesve, pa arritur efektivitet ekonomik në realizimin e prokurimit.

8. z. R.Q, në cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël.

9. z. L.SH, në cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël.

10.z. R.D, në cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël.

KPP ka skualifikuar operatorët ekonomik “I...A”, “A...A” dhe “U...I”. shpk në kundërshtim me LPP, RrPP dhe Udhëzimin e APP, për arsye se, në këtë fazë asnjë operator ekonomik përfshi edhe ofertuesin e shpallur fitues nuk kanë paraqitur në sistem dokumentet e pranimit kualifikimit, **duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 39,000 lekë.**

Nuk është kryer procedura e arkivimit të dosjeve në sistemin e prokurimit elektronik, në kundërshtim me Urdhrin nr. 57, dt. 12.06.2014 dhe Udhëzimin e Agjencia e prokurimit publik nr. 3, datë 01.06.2010 "Për shpalljen e njoftimit të kontratës, njoftimit të fituesit dhe njoftimit të kontratës së lidhur në sistemin e prokurimit elektronik" i ndryshuar, me udhëzimin nr. 2, datë 03.04.2014.

D.3. ish Komuna Grekan

1. z. XH.Z, ish kryetar i Komunës Grekan, në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor.

Projekti i zbatimit me objekt "Sistemim kanalizimeve të ujërave të zeza për fshatin Dëshiran, komuna Grekan", me vlerë preventivi të objektit 40,130,717 lekë pa TVSH, nuk është tenderuar, në kundërshtim me ligjin LPP, RrPP dhe DST, pasi autoriteti kontraktor, në përcaktimin e fituesit, nuk ka zbatuar asnjë nga procedurat e parashikuara në dispozitat ligjore të fushës së prokurimit (LPP, RrPP dhe DST).

Autoritetit kontraktor nuk ka zhvilluar procedurë prokurimi për mbikëqyrje punimesh në objektin "Sistemim kanalizimeve të ujërave të zeza për fshatin Dëshiran, komuna Grekan", me vlerë preventivi të objektit 40,130,717 lekë pa TVSH, në kundërshtim me nenet 1, 2, 4 dhe 29 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, për arsye se autoriteti kontraktor, nuk ka zbatuar asnjë nga procedurat e parashikuara në këtë ligj.

Autoriteti kontraktor ka zgjatur afatin e zbatimit të punimeve me mbi 200 ditë, kjo në kundërshtim me Formularin e Njoftimit të Kontratës, Grafikun e Punimeve dhe ofertën e operatorit ekonomik për arsye se, titullari i autoritetit kontraktor ka ndryshuar kriteret të cilat kanë përcaktuar ofertuesin fitues, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën e penalitetet të kontratës **ose 8,266,928 lekë.**

Projekti i zbatimit, relacioni teknik, grafiku i punimeve dhe preventivi për objektin "Ndriçime të rreth rrotullimit dhe rrugëve komunale, fshati Dëshiran, komuna Grekan", me vlerë të preventivit 222,1346 lekë, nuk është tenderuar, në kundërshtim me neni 35 Konkurs projektimi të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 38 Konkursi i projektimit të VKM nr. 01, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe DST.

Autoriteti kontraktor ka zgjatur afatin e zbatimit të punimeve të objektit "Ndriçime të rreth rrotullimit dhe rrugëve komunale, fshati Dëshiran, komuna Grekan", me 35 ditë, kjo në kundërshtim me Formularin e Njoftimit të Kontratës, Grafikun e Punimeve (DST) dhe ofertën e operatorit ekonomik për arsye se, titullari i autoritetit kontraktor ka ndryshuar kriteret të cilat kanë përcaktuar ofertuesin fitues, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën e penalitetet të kontratës **ose 310,988 lekë.**

2. z. A.E, në cilësinë e kryetarit të komisionit të vlerësimit të ofertave.

3. zj. S.B, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave.

4. z. M.D, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave.

Komisioni i vlerësimit të ofertave kanë kualifikuar operatorët ekonomik, në kundërshtim me nenin 46 "Kualifikimi ofertuesve dhe 53 "Shqyrtimi i ofertave", të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, kreut V zhvillimi i procedurave, të VKM

nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi kandidatët nuk plotësonin kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në DST.

5. zj. F.S, në cilësinë e juristit në njësinë e prokurimit.

6. z. T.H, në cilësinë e specialistit në njësinë e prokurimit.

7. z. I.Q, në cilësinë e specialistit në njësinë e prokurimit specialist.

8. zj. V.M, në cilësinë e juristit në njësinë e prokurimit.

Në përcaktimet dhe miratimet e kriterëve të veçanta të kualifikimit, ka shkelje të dispozitave nga NJP, pasi kriteret e përdorura për identifikimin e ofertës ekonomikisht më të favorshme nuk i plotësojnë kushtet e nenit 46 kualifikimi i ofertuesëve, pika 1, e LPP-së, pasi nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, nuk janë objektive, përpjesëtimore me kontratën objekt prokurimi, nuk janë të përcaktuara qartë në njoftimin e kontratës apo në dokumentet e tenderave.

Kriteret e përdorura për vlerësimin e ofertave nuk janë specifikuar në mënyrë të saktë nga ana e autoritetit kontraktor, për rrjedhojë lejojnë Komisionin e Vlerësimit të Ofertave, t’i interpretojnë ato në mënyra të ndryshme në procedura të ndryshme madje në disa raste me impakt financiar në dëm të autoritetit kontraktor **në vlerën 1,236,073 lekë.**

D.4. ish komuna Kajan

1. z. L.F, me detyrë ish Kryetar i Komunës, në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor.

Autoriteti kontraktor nuk ka hartuar projekt zbatimi për objektet “Mirëmbajtje rruge”, me fond limit 249,951 lekë pa tvsh, “Mirëmbajtje rrugë arash”, me fond limit 800,000 lekë pa tvsh dhe “Rikonstruksion rruga Gjolenë”, me fond limit 800,000 lek pa tvsh, në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

Preventivi i punimeve për objektet “Mirëmbajtje rruge”, me fond limit 249,951 lekë pa tvsh, “Mirëmbajtje rrugë arash”, me fond limit 800,000 lekë pa tvsh dhe “Rikonstruksion rruga Gjolenë”, me fond limit 800,000 lek pa tvsh, miratuara nga titullari i autoritetit kontraktor janë në kundërshtim me nenin 5, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, për arsye se, nuk është hartuar nga specialistë të pajisur me licencë profesionale në fushën e projektimit.

Titullari i autoritetit kontraktor për objektet “Mirëmbajtje rruge”, me fond limit 249,951 lekë pa tvsh, “Mirëmbajtje rrugë arash”, me fond limit 800,000 lekë pa tvsh dhe “Rikonstruksion rruga Gjolenë”, me fond limit 800,000 lek pa tvsh, nuk ka zhvilluar procedurë prokurimi për mbikëqyrje punimesh, në kundërshtim me nenet 1, 2, 4 dhe 29 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” dhe Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, për arsye se autoriteti kontraktor, nuk ka zbatuar asnjë nga procedurat e parashikuara në këtë ligj.

D.5. ish Komuna Fierzë

1. z. B.P, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave

2. z. H.M, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave

3. z. I.D, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave

Komisioni i vlerësimit të ofertave kanë kualifikuar operatorët ekonomik, në kundërshtim me nenin 46 “Kualifikimi ofertuesve dhe 53 “Shqyrtimi i ofertave”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kreut V zhvillimi i procedurave, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi kandidatët nuk plotësonin kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në DST.

4. z. L.S, në cilësinë e juristit në njësinë e prokurimit

5. z. Sh.I, në cilësinë e specialistit në njësinë e prokurimit

6. z. B.I, në njësinë e specialistit në njësinë e prokurimit.

Njësia e Prokurimit nuk ka argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, konform me Rregullat e Prokurimit Publik, të miratuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 10.01.2007, kreu V, i ndryshuar, i cili përcakton se, për vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, të parashikuar në Ligjin e Prokurimeve Publike (LPP) dhe në këto rregulla, njësia duhet të argumentojë me hollësi vendosjen e tyre, sipas natyrës dhe vëllimit të kontratës. Kërkesat/kriteret e veçanta të kualifikimit kanë çuar në rritjen e kostos së punëve, shërbimeve dhe mallrave, duke paguar më shumë për diferencat në kualifikimin e ofertuesve, pa arritur efektivitet ekonomik në realizimin e prokurimit.

7. z. B.P, në cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimeve me vlerë të vogël.

8. z. R.H, në cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimeve me vlerë të vogël.

9. z. H.M, në cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimeve me vlerë të vogël.

Komisioni i Prokurimeve me Vlerë të vogël ka s`kualifikuar operatorët ekonomik “I...A”, “A...A”, “A...O”, T.Y, A.D. dhe “U...I” shpk, në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i rrugëve komunale, komuna Fierzë” me fond limit 416,667 leke pa TVSH, në kundërshtim me LPP, RrPP dhe Udhëzimit të APP, për arsye se, në këtë fazë asnjë operator ekonomik përfshi edhe ofertuesin “Blerimi” të shpallur fitues nga komisioni, nuk ka paraqitur në sistem kriteret e pranim kualifikimit, duke shkaktuar dëm ekonomik **në vlerën 216,001 lekë.**

10. z. Sh.I, në cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimeve me vlerë të vogël.

11. z. B.I, në cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimeve me vlerë të vogël.

12. z. L.S, në cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimeve me vlerë të vogël.

Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël kanë përdorur dy standarde të ndryshme në shqyrtimin e ofertave të operatorëve ekonomik duke s`kualifikua ofertën e OE “Zenit 06” me vlerë më të ulët se ofertuesit të shpallur fitues, kjo në kundërshtim me Udhëzimin e APP, RrPP dhe LPP, gjë që ka shkaktuar dëm ekonomik **në vlerën 220,000 lekë.**

D.6 Bashkia Belsh

1. Nga Bashkia Belsh të merren masa që në mbështetje të ligjit nr. 8402 dt. 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16, t’i kërkojë Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor, **të vendosë masë administrative me gjobë për ing. L.P.** nën cilësinë e mbikëqyrësit, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të kontratës e me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore si dhe për mangësitë në dokumentacion, në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.3, kontratën e mbikëqyrjes së punimeve si dhe Vendimin Nr. 514 të Këshillit të Ministrave, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pikat 2, 3 dhe 9 dhe Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në UKM nr.3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 4, paragrafi 4.

2. Nga Bashkia Belsh të merren masa që në mbështetje të ligjit nr. 8402 dt. 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16, t’i kërkojë Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor, **të vendosë masë administrative me gjobë për ing. D.P.** nën cilësinë e mbikëqyrësit, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të kontratës e me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore si dhe për mangësitë në dokumentacion, në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar dhe kontratën e mbikëqyrjes së punimeve me nr. 5/2 prot., datë 12.11.2012, pika 1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu I, pika 15, germa ç dhe Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në UKM nr.3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 4, paragrafi 4.

3. Nga Bashkia Belsh të merren masa që në mbështetje të ligjit nr. 8402 dt. 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16, t’i kërkojë Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor, **të vendosë masë administrative me gjobë për shoqërinë mbikëqyrëse “Z...T” me përfaqësues ing. R.T.** nën cilësinë e mbikëqyrësit, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të kontratës e me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore si dhe për mangësitë në dokumentacion, në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.3, kontratat e mbikëqyrjes së punimeve si dhe VKM Nr.514 të Këshillit të Ministrave, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pikat 2, 3 dhe 9.

4. Nga Bashkia Belsh të merren masa që në mbështetje të ligjit nr. 8402 dt. 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16, t’i kërkojë Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor, **të vendosë masë administrative me gjobë për ing. Y.A.** nën cilësinë e kolaudatorit, për shkeljet e konstatuara në procedurat e kolaudimit të punimeve të përfunduara me punime të pakryera në fakt e me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore si dhe për mangësitë në dokumentacion, në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe

kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.3, kontratat e mbikëqyrjes së punimeve si dhe Vendimin Nr. 514 të Këshillit të Ministrave, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pikat 2, 3 dhe 9.

Për ish punonjësit:

- 1-Z. A.K, me detyrë ish kryetar i bashkisë Belsh,
- 2- Z. R.H, me detyrë ish kryetar i komunës Rasë,
- 3- Z. XH.Z, me detyrë ish kryetar i komunës Grekan,
- 4- Z. B.Q, me detyrë ish kryetar i komunës Fierzë,
- 5- Z. L.F, me detyrë ish kryetar i komunës Kajan,
- 6- Z. B.I, me detyrë ish përgjegjës i zyrës së financës komuna Fierzë,
- 7- Zj. S.B, me detyrë ish përgjegjës e zyrës së financës komuna Grekan,
- 8- Z. M.B, me detyrë ish përgjegjës i zyrës së financës komuna Kajan,
- 9- Z. R.Q, me detyrë ish përgjegjës i zyrës së financës komuna Rasë,
- 10-Z. R.B, me detyrë ish ekonomist i pagave dhe në cilësinë e anëtarit të komisionit për shërbime dhe blerje të vogla bashkia Belsh,
- 11- Z. B.P, me detyrë ish përgjegjës i zyrës së urbanistikës dhe në cilësinë e anëtarit të komisionit për shërbime dhe blerje të vogla bashkia Belsh,
- 12- Z. Q.R, me detyrë ish përgjegjës i Zyrës së Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës komuna Grekan,
- 13- Z. R.A, me detyrë ish përgjegjës i Zyrës së Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës komuna Rasë
- 14- Z. A.D, me detyrë ish përgjegjës i Zyrës së Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës komuna Rasë.
- 15-Zj. A.M, me detyrë ish juriste në bashkinë Belsh,

Nuk rekomandojmë masa disiplinore sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë, janë të nivelit që ezaurohen me zbatimin e rekomandimeve për masa administrative dhe shpërblim i dëmit. Këta persona nuk janë në marrëdhënie pune me bashkinë Belsh.

Shënim: Në vlerësimin e kryer mbi zbatimin e standardeve dhe cilësinë e auditimit, puna e kryer nga grupi i auditimit, vlerësohet jo e plotë nga Kryetari i KLSH, dhe kjo dosje do të kalojë në kontroll në të ftohtë, për një rivlerësim dhe rishikim të pikave të programit, që nuk janë realizuar plotësisht, si dhe nëse do jetë nevoja do të kryhet auditim në një kohë të dytë, me grup tjetër audituesish shtetëror.

E. VLERËSIMI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE

KLSH do të ndjek me vëmendje të veçantë dhe vlerësojë dhe marrjen e masave, që do të marrë Bashkia Belsh për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga auditimi i kryer, reflektimin e tyre në përmirësimin e proceseve të veprimtarisë ekonomiko financiare, me qëllim mirë përdorimin e fondeve publike, në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit në shërbim të komunitetit.

Në përfundim të afateve të përcaktuara në rekomandimet e dërguara dhe afatin e caktuar 6 muaj, në nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *“Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*, do të kryejmë auditim të veçantë, për ecurinë dhe nivelin e zbatimit të masave të rekomanduara.

Nga Bashkia Belsh, nuk është kthyer përgjigje akoma, së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, pasi nuk është ezauruar afati ligjor prej 20 ditë, pra rezulton se rekomandimet janë në proces vlerësimi.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Josif Lile, Shefki Jaupi, Aleksandër Papadhimetri, Vasil Vane dhe Jonild Hoxhaj, më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Xhaferr Xhoxhaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT